



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN	KOSOVSKA AGENCIJA	KOSOVO ENVIRONMENTAL
E MJEDISIT TË KOSOVËS	ZA ZAŠTITU SREDINE	PROTECTION AGENCY

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

RISHPALLJE E NJOFTIMIT

Njoftohen qytetarët, institucionet, organizatat, komunitetet lokale dhe palët e tjera të interesuara se, **me qëllim të sigurimit të një procesi sa më gjithëpërfshirës dhe mundësimit të paraqitjes së komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve nga të gjitha palët e interesit**, rishpallet konsultimi publik për dokumentin:

ARSYESHMËRIA PROFESIONALE PËR SHPALLJEN E ZONËS “GURI I HOXHËS ME GRYKËN E LUMIT DHE LIQENIN E PËRLEPNICËS”, SI ZONË TË MBROJTUR TË NATYRËS

Konsultimi publik do të jetë i hapur për **30 ditë, nga data 25.09.2026 deri më 24.10.2026**, në pajtim me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

Gjatë kësaj periudhe, të interesuarit mund të njihen me dokumentin dhe të paraqesin komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen në kuadër të procedurës për shpalljen e zonës së mbrojtur.

Pas përfundimit të periudhës 30-ditore, **më 26.10.2026, do të mbahen debatet publike:**

Komuna e Gjilanit – nga ora **10:00**, në objektin e Komunës së Gjilanit.

Komuna e Ranillugut – nga ora **13:00**, në objektin e Komunës së Ranillukut.

Komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e pranuar gjatë konsultimit publik të zhvilluar nga data 27.04.2026 deri më 28.05.2026 mbeten të vlefshme dhe do të trajtohen së bashku me ato që pranohen gjatë kësaj rishpalljeje. Palët që kanë dorëzuar komente më parë nuk kanë nevojë t'i ridërgojnë ato.

Dokumenti mund të gjendet dhe shkarkohet nga ueb-faqja e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (<https://ammk-rks.net/al/informata-njoftime>), si dhe të konsultohet në kopje fizike në komunat e Gjilanit dhe Ranillukut.

Komentet dhe sugjerimet shtesë mund të dorëzohen deri më **25.10.2026, në orën 16:00**, në adresën elektronike: sami.behrani@rks-gov.net